# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6947
E mërkurë, 19 korrik 2023
Çmimi 0.40 €


## Bislimi dhe Petkoviqi të mërkurën në Bruksel FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PRESIDENTJA VJOSA OSMANI PRITI TË MARTËN NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E ORGANIZATAVE TË DALA NGA LUFTA E UÇK-së FAQE 4-5

# ORGANIZATAT E DALA NGA LUFTA E UÇK-së I KËRKOJNË OSMANIT MOS TA DEKRETOJË LIGJIN PËR PAGËN MINIMALE

## - Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së paralajmërojnë protestë më 26 korrik



Përfaqësuesit e tri organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, pas takimit me presidenten e vendit, Vjosa Osmani, të martën kanë bërë me dije se ia kanë bërë të qartë Osmanit që mos ta nënshkruajë Ligjin për Pagën Minimale, nga i cili janë përjashtuar veteranët. Sipas tyre, do t'i shikojnë të gjitha rrugët ligjore që ta parandalojnë hyrjen në fuqi të këtij ligji. Ushtruesi i detyrës së OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka theksuar se qeveria Kurti vazhdimisht po e godet UÇK-në. "E kemi paralajmëruar më 26 korrik protestën tonë, po atë ditë që do të mbahet seanca", është shprehur Klinaku



## EVROPA PËRGATITET PËR KULMIN E TË NXEHTIT TEKSA BOTA SHËNON TEMPERATURA REKORDE FAQE 2

## SHTENSIONIMI NË VERI, 'NË GJYSMË TË RRUGËS' FAQE 7



## AKTUALE



### RADONIQI E SZUNYOG FLASIN PËR HARMONIZIMIN E RREGULLOREVE ME LIGJIN PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME F. 3

### SINDIKATA DORËZON NË KUVEND NJË PETICION ME PAKËNAQËSITË E POLICËVE F. 5

### MALISHEVËS I SHTOHEN EDHE DY ÇERDHE PUBLIKE ME 115 FËMIJË F. 7

## EKONOMI



### KRU "PRISHTINA" NIS SHKYÇJET: BORXHI I KONSUMATORËVE, MBI 45 MILIONË EURO F. 8

### PARAQITET RASTI I PARË NË KOSOVË I SËMUNDJES MURTAJA AFRIKANE E DERRIT F. 8

## SPORT



### KLUBET E HENDBOLLIT I MËSOJNË KUNDËRSHTARËT EVROPIANË F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Trumpi thotë se pret të paditet në rastin për trazirat në Kongres



UASHINGTON, 18 KORRIK - Ish-presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se pret të arrestohet nga autoritetet për trazirat e 6 janarit të vitit 2021 në ndërtesën e Kongresit Amerikan dhe përpjekjet për t'i sfiduar rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2020. Në rrjetet sociale ai ka thënë se është informuar nga prokurori special Jack Smith, në mbrëmjen e së dielës, se ai është në shënjestër të hetimeve.

Mes të tjerash, Trumpi e ka përmendur se i është thënë të raportojë para një jurie të madhe "që, pothuajse, gjithmonë nënkupton arrestim apo padi".

Smith nuk u është përgjigjur kërkesave të medieve për koment.

Nëse konfirmohet, ajo do të jetë padia e tretë për Trumpin lidhur me shkeljet e supozuara penale, përfshirë edhe akuzat e ekipit të Smithit se ish-presidenti nuk i ka menaxhuar mirë dokumentet e klasifikuara.

Trumpi është akuzuar edhe në Nju-Jork për falsifikim të dokumenteve biznesore më 2016, kur e ka bërë një pagesë për të blerë heshtjen e një ylli të pornografisë.

Smith është emëruar prokuror special pak pasi Trumpi ka konfirmuar se e synon edhe një mandat presidencial në ShBA.

Ekipi i Smithit ka kryer intervista me dhjetëra zyrtarë dhe këshilltarë të administratës Trump, përfshirë ish-nënpresidentin Mike Pence dhe avokatin e Trumpit, Rudy Giuliani.

Në trazirat e janarit të vitit 2021, mbështetësit e ish-presidentit Donald Trump e kanë kundërshtuar rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020, të cilat i ka fituar presidenti aktual, Joe Biden, dhe kanë hyrë në ndërtesë të Kongresit.

# Evropa përgatitet për kulmin e të nxehtit teksa bota shënon temperatura rekorde

Athinë, 18 korrik - Evropa po përgatitet për temperatura të larta të martën, gjatë një vale nxehtësie ndërkohë që zjarret kanë përfshirë pjesë të hemisferës veriore, duke shtyrë autoritetet të bëjnë evakuimin e 1 200 fëmijëve pranë një resorti bregdetar grek.

Autoritetet shëndetësore, nga Amerika e Veriut, Evropa e Azia, kanë lëshuar paralajmërime, duke u kërkuar njerëzve të qëndrojnë të hidratuar dhe të kërkojnë strehim nga dielli përvëlues.

Evropa, kontinenti me ngrohjen më të shpejtë në botë, po përgatitet për kulmin e valës aktuale të të nxehtit, me ishujt italianë të Sicilisë dhe Sardenjës, të cilët do të goditen nga një temperaturë maksimale prej 48 gradësh celsius, ka parashikuar Agjencia Evropiane e Hapësirës.

Rekordi i mëparshëm i temperaturës në Evropë u regjistrua në vitin 2021 në Sicili, që arriti në 48.8 gradë celsius, sipas Agjencisë së Motit të OKB-së.

Në afërsi të Athinës shërbimet e urgjencës vazhduan t'i luftojnë zjarret për të dytën ditë radhazi në lokacione të ndryshme. "Shqetësimi ynë kryesor është t'i mbrojmë njerëzit", tha një zëdhënës i zjarrfikësve në Greqi.

Një zjarr në pyll u ndez nga erërat e forta pranë qytetit të plazhit të Loutrakis, ku kryebashkiaku tha se 1 200 fëmijë ishin evakuuar nga kampet e pushimeve. "Moti ekstrem... po ka një ndikim të madh në shëndetin e njerëzve, ekosistemet, ekonomitë, bujqësinë, energjinë dhe furnizimet me ujë", tha sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Botërore Meteorologjike (WMO), Petteri Taalas. "Kjo thekson urgjencën në rritje të uljes së emetimeve të karbonit sa më shpejt që të jetë e mundur", tha ai.

Në Evropë italianët u paralajmëruan të përgatiteshin për "valën më intensive të të nxehtit", pasi temperaturat arritën një rekord prej 39 gradësh celsius të hënën në Romë.

Një turist amerikan, Colman Peavy, nuk i besonte vapës teksa pinte një kafe me gruan e tij Ana në fillim të një pushimi dyjavor.



## Rusia thotë se ura e Krimesë është rihapur pjesërisht



MOSKË, 18 KORRIK - Rusia tha më 18 korrik se trafiku rrugor është rihapur pjesërisht në urën kryesore që lidh Gadishullin e Krimesë me Rusinë mbi ngushticën e Kerçit, pasi ajo ishte dëmtuar nga një shpërthim një ditë më parë.

Rusia e ka fajësuar Ukrainën për shpërthimin, nga i cili humbën jetën dy persona dhe vajza e tyre u plagos rëndë.

Autoritetet ruse thanë se kanë goditur objektet në Odesa të Ukrainës dhe Mikolaiv, në shenjë hakmarrjeje për sulmin në urë.

Presidenti Vladimir Putin, i cili e ka prezantuar personalisht urën pas aneksimit të Krimesë në vitin 2014, u zotua për "një përgjigje" për atë që Rusia e quajti "sulm terrorist".

Ukraina nuk mori përgjegjësinë për sulmin, por mediet ukrainase raportuan se shërbimet e sigurisë kishin vendosur dy dronë detarë për ta kryer operacionin.

Zëvendëskryeministri rus Marat Khusnullin, i cili është vënë në krye të punimeve për riparimin e urës, shkroi në Telegram mëngjesin e 18 korrikut se "transporti në Urën e Krimesë është rikthyer".

Khusnullin tha se një pjesë e rrugës në urë është shkatërruar dhe do të duhet të rindërtohet, por se nuk ka dëmtime strukturore në shtyllat e urës. Ai shtoi se ura do të riparohet plotësisht deri më 1 nëntor.

Dëmi i shkaktuar në urë, e vetmja rrugë që lidh Krimenë me Rusinë, mund të ketë ndikim në aftësinë e Moskës për t'i furnizuar trupat e saj në Ukrainën jugore.

Më 17 korrik Putini kërkoi propozime për ta garantuar sigurinë e urës, e cila po riparohet për herë të dytë për shkak të një sulmi të mëparshëm në tetor.

Ura rrugore dhe hekurudhore prej 19 kilometrash u hap në vitin 2018 dhe është një rrugë e rëndësishme transporti midis Rusisë dhe rajonit të Krimesë, të cilën Moska e aneksoi ilegalisht në 2014.

Ura u mbyll pjesërisht pasi një shpërthim i madh në tetor të vitit të kaluar dëmtoi strukturën e saj në atë që Moska pretendoi se ishte një akt terrorist.

Në fillim të këtij muaji, përmes një postimi në rrjete sociale që përkujtonte 500 ditët e luftës, zëvendësministrja e Mbrojtjes, Hanna Malyar, dukej se pranonte përfshirjen e Ukrainës në sulmin e mëparshëm të urës.

Ajo përmendi se "273 ditë më parë, [ne] filluam goditjen e parë në urën e Krimesë për ta prishur logjistikën ruse".

Pas këtij incidenti, Rusia rindërtoi urën. Presidenti Putin drejtoi një makinë nëpër strukturën e restauruar më 5 dhjetor, pasi u kryen riparime të shumta.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Radoniqi e Szunyog flasin për harmonizimin e rregulloreve me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme

Prishtinë, 18 korrik - Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka pritur të martën në takim shefin e zyrës së BE-së, njëherësh përfaqësues i posaçëm i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Në këtë takim Radoniqi mirëpriti përfundimin e procesit të reformës zgjedhore, ndërsa bisedoi me ambasadorin Szunyog lidhur me angazhimin aktual të KQZ-së për harmonizimin e Rregulloreve Zgjedhore me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili është miratuar në fillim të qershorit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, Radoniqi falënderoi Zyrën e BE-së në Kosovë që është bërë pjesë e këtij procesi. Nga ana e tij, ambasadori Szunyog u shpreh i kënaqur që në reformë zgjedhore janë përfshirë shumica e rekomandimeve të vëzhguesve të Bashkimit Evropian, të cilët që nga viti 2013 kanë vëzhguar nga afër proceset zgjedhore në Kosovë. Po ashtu, ai shprehu gatishmërinë për ta vazhduar mbështetjen për KQZ-në për harmonizimin e akteve nënligjore me ligjin e ri.



# Për gjashtë muaj në Klinikën e Kardiologjisë janë realizuar 1 902 koronarografi




Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 18 korrik -** Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar nga drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, ka vizituar Klinikën e Kardiologjisë, me ç'rast është njoftuar për dinamikën e shtuar të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët gjatë pjesës së parë të vitit 2023.

Drejtori i Klinikës së Kardiologjisë, dr. Lulzim Kamberi, e njoftoi ministrin Vitia se gjatë gjashtëmujorit të parë këtij viti në Klinikën e Kardiologjisë janë realizuar 1 902 koronarografi, ndërsa janë bërë 1 786 stentime.

Gjithashtu, janë realizuar 1 832 procedura të stentimeve.

Krahasuar me vitin paraprak, kur përgjatë një viti ishin realizuar 2 929 koronarografi dhe 2 727 stentime, vëllimi i punës në këtë vit paraqet mundësinë e dyfishimit të numrit të intervenimeve që kanë të bëjnë me sëmundjet kardiake.

Gjithashtu, ministri Vitia u njoftua se në shërbimin e Elektrosimulimit dhe Elektrofiziologjisë në Klinikën e Kardiologjisë për herë të parë në vend dhe më gjerë është realizuar me sukses procedura e stimulimit selektiv të sistemit përçues të zemrës (pace - im) me qëllim të realizimit të një hapshënimi sa më fiziologjik.

Një ndërhyrje e tillë është realizuar te një paciente e moshës 26-vjeçare me çrregullime të përçimit atrioventrikular pas një intervenimi kirurgjik në zemrën e pacientes.

Në Klinikën e Kardiologjisë janë realizuar me sukses edhe pesë "pacemaker" biventrukular (CRT - P), pajisje që bëjnë resinkronizimin elektrik të punës së zemrës te pacientët që kanë dëmtim të avancuar të muskulit të zemrës. Intervenimet e tilla të avancuara janë realizuar nën mbikëqyrjen e ekspertëve shëndetësorë kroatë nga Spitali Universitar i Rjekës.

Ministri Vitia e përgëzoi stafin për shtimin e vëllimit të punës, ndërsa tha se Ministria e Shëndetësisë mbetet e përkushtuar që t'i përkrahë të gjitha kërkesat që do ta shtojnë vëllimin e punës dhe do ta rritin cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

## Lushtaku: Ftoj publikisht Besnik Berishën t'i bashkohet PDK-së, ai nuk është për LDK-në

**Prishtinë, 18 korrik -** Nënkryetari i Skenderajt dhe një prej figurave kryesore të PDK-së, Sami Lushtaku, ka reaguar ndaj intervistës që avokati Besnik Berisha ka dhënë pas lirimit nga mbajtja. Lushtaku ka thënë se e ka dëgjuar me vëmendje intervistën e Berishës pas lirimit dhe e ka ftuar t'i bashkohet PDK-së meqë, sipas Lushtakut, me një qasje të tillë ai s'është për LDK-në. "E dëgjova me vëmendje intervistën e avokatit Besnik Berisha të dhënë për Berat Buzhalën. Duke e parë qasjen e tij, e ftoj publikisht Besnikun t'i bashkohet PDK-së sepse ai nuk është për LDK!", ka shkruar Lushtaku në "Facebook".





PRESIDENTJA VJOSA OSMANI PRITI TË MARTËN NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E ORGANIZATAVE TË DALA NGA LUFTA E UÇK-SË

# Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së i kërkojnë Osmanit mos ta dekretojë Ligjin për Pagën Minimale

*- Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së paralajmërojnë protestë më 26 korrik*

Përfaqësuesit e tri organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, pas takimit me presidenten e vendit, Vjosa Osmani, të martën kanë bërë me dije se ia kanë bërë të qartë Osmanit që mos ta nënshkruajë Ligjin për Pagën Minimale, nga i cili janë përjashtuar veteranët. Sipas tyre, do t'i shikojnë të gjitha rrugët ligjore që ta parandalojnë hyrjen në fuqi të këtij ligji. Ushtruesi i detyrës së OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka theksuar se qeveria Kurti vazhdimisht po e godet UÇK-në. "E kemi paralajmëruar më 26 korrik protestën tonë, po atë ditë që do të mbahet seanca", është shprehur Klinaku

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 18 korrik** - Përfaqësuesit e tri organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, kanë bërë me dije se ia kanë bërë të qartë Osmanit që mos ta nënshkruajë Ligjin për Pagën Minimale, nga i cili janë përjashtuar veteranët. Ata kanë thënë se me të është shkelur dinjiteti i veteranëve të UÇK-së, duke theksuar se adresa e tyre e fundit ka mbetur Presidenca.

Ushtruesi i detyrës së OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se si organizata të dala nga lufta nuk kanë pasur kontakt as me Qeverinë dhe as me Kuvendin, pasi janë injoruar nga këto dy institucione. Ai tha se u erdhi mirë që presidentja e vendit pranoi kërkesën për takim. "Ne i paraqitem të gjitha shqetësimet tona. Kjo qeveri që dy vjet e gjysmë as protezat veteranëve nuk ua rregullon", ka thënë Klinaku, duke theksuar se kjo qeveri vazhdimisht po e godet UÇK-në. "Veprimet tona nuk ndërlidhen me presidenten. Ajo e ka për obligim ta kryejë si duhet punën e saj, sepse paraqet unitetin e popullit dhe nuk duhet të krijojë përçarje. Kundërshtimet tona vazhdojnë. E kemi paralajmëruar më 26 korrik protestën tonë, po atë ditë që do të mbahet seanca", është shprehur Klinaku.

Kryetari i Shoqatës së Familjarëve së Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka thënë se do ta bllokojnë punën e Kuvendit të Kosovës. "Qëndrimi ynë është të mbajmë protesta dhe ta bllokojmë punën e Kuvendit. Kërkesa jonë ishte që mos ta dekretojë këtë ligj, pra mos ta nënshkruajë", ka thënë Jashari.

Ai tha se Osmanin e njoftuan që këtë ligj do ta kundërshtojnë me të gjitha format, edhe duke protestuar. "Do ta vazhdojmë rrugën ligjore, edhe protestat, për të kundërshtuar këtë padrejtësi. U shkel dinjiteti i kësaj kategorie, pra i luftës së lavdishme të UÇK-së. Kjo qeveri nuk dëshiron të dijë rrugën se si kemi ardhur deri këtu, me plot sakrificë, me plot mund, me gjakun e dëshmorëve, me gjymtyrët e invalidëve dhe me luftën e pjesëtarëve të UÇK-së, tash veteranë të luftës", është shprehur Jashari, duke shtuar se organizimet do t'i bëjnë shumë më të fuqishme.

Duke folur për përgjimet e pushtetit me Listën Serbe për veteranët e UÇK-së, Jashari ka thënë se asnjë njeri që jeton sot në Kosovë nuk do të ndihet mirë kur dëgjon ato përgjime për ta diskriminuar vlerën tonë kombëtare të luftës, UÇK-në.

Pjesë e takimit me presidenten Osmani ishte edhe kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Fadil Shurdhaj.

Ndërkaq Presidenca në njoftimin e saj për medie ka dhënë hollësi të takimit me këto organizata të luftës. "Presidentja Vjosa Osmani priti sot në takim përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së: Organizatën e Veteranëve, Shoqatën e Invalidëve dhe Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve, të cilët i adresuan shqetësimet e tyre në raport me përmbajtjen e Ligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, që u miratua javën e kaluar në Kuvendin e Kosovës. Në takim me përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, presidentja Osmani i ka njoftuar ata se Ligji për Pagën Minimale ende ndodhet në Kuvend dhe sapo të vjen në Presidencë do të trajtohet nga ana e ekspertëve ligjorë në Presidencë dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese të institucionit të Presidencës", ka njoftuar Presidenca e Kosovës.

Më tej është thënë se ky ligj do të analizohet nga zyra e presidentes, më pas do të veprohet në përputhje me përgjegjësitë kushtetuese e ligjore të presidentes dhe duke pasur parasysh rëndësinë e trajtimit të dinjitetshëm të këtyre kategorive. "Në këtë takim organizatat e dala nga lufta e UÇK-së prezantuan edhe disa nga sfidat me të cilat përballen këto kategori dhe u dakorduan ta vazhdojnë komunikimin për trajtimin e tyre", ka njoftuar Presidenca.

# Bislimi dhe Petkoviqi të mërkurën në Bruksel

**Prishtinë, 18 korrik** - Zëvendëskryeministri dhe kryenegociatori i Kosovës për dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, do të marrë pjesë në takimin e planifikuar të mërkurën në Bruksel në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, tha këshilltari i tij politik Klisman Kadiu për Radion Evropa e Lirë.
Edhe pse nga Bashkimi Evropian (BE) kanë thënë se synohet që nesër delegacionet e Kosovës dhe Serbisë të takohen edhe mes vete, një gjë të tillë nuk kanë mundur ta konfirmojnë sot në Bruksel.
Një burim i BE-së ka thënë se “kjo do të varet edhe nga vullneti dhe gatishmëria e palëve, më saktësisht nga kryenegociatorët”, ndërsa BE-ja “gjithsesi ka synim që të ketë edhe takim trepalësh”.
Kadiu tha të martën në mëngjes për Radion Evropa e Lirë: “Mund të konfirmoj nga ana jonë, zëvendëskryeministri Bislimi nesër do të jetë në Bruksel”.
Deri më tash ka ndodhur shpesh që në takimet e dialogut të ketë vetëm takime dypalëshe mes përfaqësuesve të BE-së me delegacionet e Kosovës dhe Serbisë veç e veç, ndërsa palët kanë refuzuar disa herë që të ketë takime të përbashkëta.
Kështu kishte ndodhur edhe herën e fundit kur në Bruksel ishin kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiq. Ata patën takime të ndara me përfaqësuesin e lartë të BE-së, Josep Borrell, por jo edhe mes vete.
Ndërkohë, në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, konfirmoi më herët gjatë ditës se i dërguari për dialogun, Miroslav Lajçak, do t'i presë në takim kryenegociatorët nga të dyja palët. “Fokusi do të jetë tek implementimi i marrëveshjes së 27 shkurtit [Marrëveshja Bazë] dhe hapat për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës”, tha Stano.
Takimi në Bruksel është hapi i katërt i dakorduar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës.
Më 10 korrik Bashkimi Evropian dhe Kosova ranë dakord për një sërë hapash që Kosova duhet t’i ndërmarrë si pjesë e veprimeve për ta shtensionuar situatën e krijuar në veri të vendit.



Qeveria e Kosovës ka thënë se të gjithë hapat do të “finalizohen brenda një periudhe dyjavore”.
Tensionet në veri të Kosovës kanë qenë të larta që disa javë, sidomos në muajin qershor.
Situata është përkeqësuar pasi serbët lokalë në komunat në veri të Kosovës - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë, me asistimin e Policisë së Kosovës, në ndërtesat komunale.
Kryetarët i kanë fituar mandatet në zgjedhjet e mbajtura në prill të këtij viti, të cilat i kanë bojkotuar serbët.
Për shkak të mosdëgjimit të këshillave të faktorit ndërkombëtar për dhënie fund të krizës, Kosova është përballur me masa ndëshkuese nga BE-ja.
Masat ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës përfshijnë: suspendimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe suspendimin e vizitave bilaterale, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja.
Kosova dhe Serbia janë pjesë e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizim të raporteve që prej vitit 2011.
Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

# Sindikata dorëzon në Kuvend një peticion me pakënaqësitë e policëve



**Prishtinë, 18 korrik** - Sindikata e Policisë së Kosovës ka njoftuar të martën se ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës një peticion të nënshkruar nga punonjësit policorë lidhur me pakënaqësitë e tyre. Në njoftim bëhet me dije se Ligji i Pagave, mungesa e sigurimit shëndetësor e jetësor, Ligji i Pensionimit, shtesat për punë specifike, rrezikshmëria dhe kushtet e punës janë disa nga pakënaqësitë e zyrtarëve policorë. “Sindikata e Policisë së Kosovës njofton punonjësit e Policisë së Kosovës dhe opinionin e gjerë se ky është një nga hapat sindikal drejt realizimit të kërkesave tona ligjore”, thuhet në komunikatën për medie.

## Malishevës i shtohen edhe dy çerdhe publike me 115 fëmijë

**Malishevë, 18 korrik** - Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim (DAE) në komunën e Malishevës, Arbëreshë Krasniqi, ka bërë me dije se në shtator do të hapen edhe dy institucione parashkollore me kapacitet për mbi 115 fëmijë. Njëra çerdhe do të hapet në Malishevë, tjetra në Kijevë, ndërsa shumë shpejt do të hapet edhe çerdhja e katërt. "Edukimi i hershëm i fëmijëve të komunës së Malishevës ka qenë një prej prioriteteve tona si qeverisje komunale. Me angazhimet tona maksimale dhe me përkrahjen e parezervë të kryetarit Ekrem Kastrati, e kemi bërë realitet këtë premtim. Përveç këtyre dy institucioneve të reja parashkollore, po punohet intensivisht për hapjen e çerdhes së katërt në komunën tonë", ka theksuar Krasniqi.





# Policia në rajonin e Mitrovicës shpërndan fletushka për parandalimin e zhurmës dhe bezdisjes

**Mitrovicë, 18 korrik** - Me qëllim të vetëdijesimit dhe parandalimit të zhurmës dhe bezdisjes, Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut, bazuar në planin e veprimit (sezoni veror 2023), ka filluar së realizuari aktivitet vetëdijesimi me moton "Mos shkakto zhurmë-bezdisje".

Përmes këtij aktiviteti dhe shpërndarjes së fletushkave synohet të vetëdijesohen qytetarët, në veçanti veprimtaritë e bizneseve, për parandalimin e zhurmës dhe bezdisjes.

Duke pasur parasysh sezonin veror, në këto rrethana veprimet policore do të jenë të bashkërenduara me autoritetet komunale, përfshirë inspektorët komunalë ku, përveç pjesës preventive-sensibilizimit , veprimet e përbashkëta do të jenë në përputhje me autorizimet ndërinstitucionale në zbatim të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike - nr. 03/L-142 neni-8.

Angazhimet e shtuara policore do të vazhdojnë gjatë gjithë sezonit veror. Me prioritet kohor do të jenë orët e mbrëmjes dhe natës, e në fokus do të jenë zonat ku operojnë lokalet e natës, restorantet, kafiteritë dhe diskotekat.

# Në Podujevë mbahet sesion informues për trajnimin "Kujdesi ndaj fëmijëve dhe mirëmbajtja"

**Podujevë, 18 korrik** - Në komunën e Podujevës u mbajt sesion informues për trajnimin "Kujdesi ndaj fëmijëve dhe mirëmbajtja" nga organizata Kosova - Women 4 Women, program i cili do t'u ofrojë pjesëmarrësve një muaj praktikë me pagesë në institucione publike parashkollore.

Gjatë sesionit u regjistruan mbi 25 pjesëmarrëse për trajnim i cili do të ofrohet falas nga organizata Kosova - Women 4 Women. Qëllimi i projektit është mbështetja e grave të margjinalizuara, përmirësimi i mirëqenies dhe ndikimi në vendimmarrje brenda familjes dhe komunitetit, të krijojnë rrjete të mbështetjes, duke shfrytëzuar aftësitë dhe njohuritë gratë do të jenë në gjendje të krijojnë ndryshime të qëndrueshme për veten e tyre, familjet e tyre dhe komunitetin.



Pjesëmarrëset do të certifikohen dhe do t'u mundësohet praktika në një nga institucionet publike parashkollore të Podujevës. Ky trajnim po mbahet në kuadër të projektit "Së bashku ndërtojmë reziliencën", i financuar nga Fondi i Mirëbesimit i OKB-së për t'i dhënë fund dhunës kundër grave (UN Trust Fund).

# Në Gjilan hapet fushata e korrje-shirjeve

**Gjilan, 18 korrik** - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me fermerët dhe kombajnerët e komunës, ka hapur të martën zyrtarisht fushatën e korrje-shirjeve. Ai bëri me dije se të mbjella në komunën e Gjilanit janë rreth 3 100 hektarë grurë, 100 hektarë elb dhe 10 hektarë thekër. "Me projektin për farën e grurit për mbjelljet aktuale, kemi përkrahur fermerët tanë me 140 tonë grurë. Duke konsideruar se kultivimi i grurit është me shumë interes për shoqërinë, për këtë vit planifikojmë të rritim sasinë e farës për 40 %, që do të jetë 200 tonë. Punë të mbarë të gjithë fermerëve në fushatën e korrje-shirjeve. Qoftë ky vit i bereqetshëm!", ka thënë kryetari Hyseni.



## Testit të arritshmërisë i janë nënshtruar mbi 23 mijë nxënës të klasave të nënta



**Prishtinë, 18 korrik** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) ka publikuar rezultatet e testit të arritshmërisë, sipas të cilave, arritshmëria e përgjithshme në test është 52.1 për qind. Sipas rezultateve të publikuara në të gjitha shkollat e vendit, arritshmëria sipas lëndëve është: Gjuhë shqipe 68.8 për qind, gjuhë angleze 62 për qind, histori 55.2 për qind, gjeografi 49.2 për qind, matematikë 44.9 për qind, informatikë 53.4 për qind, fizikë 42.9 për qind, kimi 44.4 për qind, biologji 51.8 për qind.

Gjatë këtij viti testit të arritshmërisë i janë nënshtruar mbi 23 mijë nxënës të klasave të nënta, të cilët kanë qenë të sistemuar në 176 qendra të testimit, respektivisht në 1 867 salla të testimit.


Ibrahim Berisha (RFE/RL)

# Shtensionimi në veri, 'në gjysmë të rrugës'

**Prishtinë, 18 korrik -** Hapat për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës - rajon i banuar me shumicë serbe - janë ata që negociatorët kryesorë të Prishtinës dhe të Beogradit duhet t'i diskutojnë në një takim në Bruksel më 19 korrik.

Nga Bashkimi Evropian kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" edhe takimin, edhe pjesëmarrjen e të dy kryenegociatorëve, Besnik Bislimit nga Kosova dhe Petar Petkoviqit nga Serbia.

Të hënën, derisa disa udhëheqës të Ballkanit Perëndimor janë takuar në Tiranë me komisionarin e BE-së për zgjerim, Oliver Varheyli, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka qenë në ishullin grek të Kretës për një konferencë mbi Ballkanin Perëndimor. Atje ai është takuar me të dërguarin e BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, ndërsa në "Twitter" ka shkruar se "moti ka qenë më i ngrohtë sesa biseda e tyre".

Qëndrimi i Kurtit për çështjen e veriut të Kosovës dhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe e ka distancuar atë nga partnerët e tij evropianë, por qeveria e tij përsërit se "Kosova do ta përmbushë atë për të cilën është pajtuar" dhe se "do të vazhdojë të jetë konstruktive në takimin e radhës në kuadër të dialogut".

Kështu thuhet në përgjigjen që "Radio Evropa e Lirë" ka marrë nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës të hënën.

## Çfarë ka ndodhur më herët?

Më 10 korrik Lajçaku dhe kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, kanë konfirmuar se në një takim në Bratislavë kanë arritur marrëveshje për shtensionimin e situatës në veri.

Një ditë më vonë janë paraqitur edhe hapat konkretë të cilët parashikojnë tërheqjen e 25 për qind të Policisë së Kosovës nga dhe rreth ndërtesave komunale në veri, organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme lokale në fund të verës dhe rikthimin në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Nga kabineti i kryeministrit të Kosovës thonë se tani i takon Serbisë t'i shprehë qëndrimet e saj për këtë çështje. "Sidoqoftë, ne besojmë se [Beogradi] duhet ta ndalë qasjen e tij destruktive dhe fushatën e frikësimit të serbëve të Kosovës", thuhet në përgjigje.

Deri më tani Beogradi zyrtar nuk e ka thënë qartë nëse kjo marrëveshje për shtensionim është e pranueshme për të, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se bëhet fjalë për një "mashtrim" të vendeve perëndimore.

## Çfarë është bërë deri tani dhe cilët janë hapat e ardhshëm?

Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se javën e kaluar 25 për qind e Policisë së Kosovës është reduktuar nga dhe rreth ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Policia ka qenë e pranishme në objektet komunale që nga fundi i majit, kur kryetarët shqiptarë kanë hyrë në zyra, me gjithë kundërshtimet e popullatës lokale serbe.

Kurti ka thënë më 12 korrik se 25 për qind e policëve nuk po tërhiqen nga veriu, por vetëm nga dhe rreth ndërtesave komunale dhe se ata do të vendosen në lokacione të tjera.

Hapa të ardhshëm për shtensionimin e situatës duhet të jenë takimi në kuadër të dialogut dhe organizimi i zgjedhjeve të reja. Megjithatë, që zgjedhjet të jenë të suksesshme, është e nevojshme pjesëmarrja e serbëve të Kosovës. Ata i kanë bojkotuar zgjedhjet e fundit në prill, me ftesë të partisë më të madhe të serbëve të Kosovës - Listës Serbe. Kjo parti, e cila ka mbështetjen e Beogradit, deri më tani nuk është deklaruar për marrëveshjen për shtensionim të situatës dhe as për pjesëmarrjen në zgjedhje.

"Radio Evropa e Lirë" i është drejtuar edhe BE-së me pyetjen nëse Serbia pritet të ndërmarrë ndonjë hap për shtensionimin e situatës, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk ka marrë përgjigje.

Përgjigje në të njëjtat pyetje nuk ka kthyer as Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.

## A ka shtensionim pa zgjedhje?

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Afrim Hoti, vlerëson se pyetja nuk është nëse Kosova dhe Serbia do të ndërmarrin hapa drejt shtensionimit, por kur do ta bëjnë këtë. Ai beson se Kurti dhe Vuçiqi, me zvarritjen që bëjnë, "blejnë kohë" deri në "qartësimin e situatës gjeopolitike për shkak të luftës në Ukrainë".

Megjithatë, shton Hoti, shtensionimi i situatës në veri nuk ka alternativë dhe tani hapi kryesor është sigurimi i pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet e parakohshme lokale. "Nuk do të ketë zgjedhje nëse nuk ka garanci nga bashkësia ndërkombëtare se serbët do të marrin pjesë në to. Besoj se kësaj radhe do të ketë organizim më të mirë dhe do të sigurohet pjesëmarrja e tyre", thotë Hoti për "Radion Evropa e Lirë".

## Pse është i diskutueshëm vullneti politik për shtensionimin e situatës?

Dushan Janjiq nga Forumi i Beogradit për Marrëdhënie Etnike thotë se praktika ka treguar se deri më tani janë gjetur zgjidhje për kriza të ndryshme në kuadër të dialogut në nivel teknik porse, më pas, sipas tij, ka munguar vullneti politik i dy udhëheqësve për zbatimin e atyre zgjidhjeve.

Dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në nivel të lartë politik aktualisht e udhëheqin kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. "Thelbi i problemit është vakuumi i sigurisë dhe institucional, i cili është krijuar kur përfaqësuesit e komunitetit serb janë larguar nga institucionet e Kosovës. Mosangazhimi në këtë drejtim flet për pamundësinë për t'i bindur të dyja palët për një marrëveshje", thotë Janjiq.

Serbët janë larguar nga institucionet e Kosovës në veri në fillim të nëntorit të vitit të kaluar, në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të qeverisë së kryeministrit Kurti për t'i riregjistruar makinat me targa të lëshuara nga Serbia në Kosovë.

Prej asaj kohe ndërmjetësuesit e vendeve perëndimore janë marrë kryesisht me tejkalimin e krizave. E fundit, e cila ka shpërthyer në fund të majit, është përshkallëzuar në dhunë, pasi protestuesit serbë janë përleshur me përfaqësuesit e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR.

## KRU "Prishtina" nis shkyçjet: Borxhi i konsumatorëve, mbi 45 milionë euro

**Prishtinë, 18 korrik** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar se do t'i shtojë shkyçjet nga shërbimet e ujësjellësit në të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Sipas KRU-së, ky veprim po merret për shkak të mospagesave për shërbimet e ujësjellësit, pasi borxhet ndaj shërbimeve të ujit janë mbi 45 milionë euro. "Borxhi ndaj shërbimeve të ujit është mbi 45 milionë euro, 40 milionë euro nga sektori i amvisërisë dhe mbi 5 milionë nga sektori i bizneseve të vogla e të mëdha. Nuk ka ujë të pijshëm pa paguar faturat e ujit, ngaqë kemi një kosto të lartë të trajtimit të ujit dhe shpërndarjes përmes tubacioneve primare, sekondare e terciare deri te konsumatorët", ka njoftuar KRU "Prishtina".
Kjo kompani shton se me ndihmën e Policisë së Kosovës shkyçjet do të realizohen në një ndër lagjet më të mëdha të Prishtinës. "Më 19 korrik 2023, duke filluar nga ora 10:00, do të rifillojmë aksion intensiv, me disa ekipe të shkyçjes, me fokus konsumatorët që kanë borxhe tejet të mëdha. Me asistencë të Policisë së Kosovës shkyçjet do të realizohen në një ndër lagjet më të mëdha të Prishtinës", ka theksuar KRU "Prishtina".



# Paraqitet rasti i parë në Kosovë i sëmundjes Murtaja Afrikane e Derrit

**Prishtinë, 18 korrik** - Një ditë më parë është konfirmuar rasti i parë i sëmundjes Murtaja Afrikane e Derrit (MAD) në komunën e Kllokotit. Pas lajmërimit për dyshime të sëmundjes, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me ekipe ka dalë në terren për hulumtim diagnostik në fermë, marrje të mostrave dhe izolim të fermës.
Rezultatet e mostrave kanë konfirmuar praninë e sëmundjes MAD.
Ekipet e inspektorëve veterinarë, bashkë me kompaninë e kontraktuar, kanë asgjësuar derrat e femrës së prekur dhe është bërë dezinfektimi i fermës dhe të gjitha gjërave rreth fermës. Ka nisur hulumtimi epidemiologjik i fermave të zonës në perimetër 3 km.
Duke u bazuar në ligjet në fuqi, AUV ka themeluar shtabin e krizës, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhim të situatës, duke mbikëqyrur veprimet për parandalim të përhapjes së sëmundjes.
Është kërkuar nga praktikat veterinare private të jenë të gatshme për mbështetje në terren, raportim të të gjitha rasteve të dyshimta dhe marrje të mostrave të gjakut.
Ka nisur kontaktimi i fermerëve mbarështues të derrave për aktivizim të masave vetëmbrojtëse të biosigurisë në fermat e tyre.
Murtaja Afrikane e Derrave MAD është sëmundje ngjitëse virale që shkakton ethe hemorragjike te derrat e butë dhe derrat egër. Përcillet me letalitet të lartë deri në 100 %. Sëmundja mund të shkaktojë dëme në ekonomitë familjare të fermerëve mbarështues të derrave. Sipas gjetjeve shkencore të deritanishme, kjo sëmundje nuk transmetohet te njeriu (kjo sëmundje nuk i prek njerëzit). Por është e ndaluar therja e kafshëve që tregojnë çfarëdo lloje shenje klinike të sëmundjes, andaj fermerët duhet të raportojnë tek autoriteti kompetent AUV kur derrat kanë simptoma. Po ashtu, gjuetarët duhet ta lajmërojnë AUV-në në çdo rast kur hasin derr të ngordhur në pyje.



## "Golden Eagle", me linjën më të madhe prodhuese në Ballkan

**Prishtinë, 18 korrik** - "Frutex" ka njoftuar se ka lëshuar në përdorim linjën më të madhe prodhuese të pijes energjike "Golden Eagle" në Ballkan. Sipas kompanisë, linjës aktuale i është shtuar kapaciteti i prodhimit prej 50 mijë copash në orë. "Kompania 'Frutex' ka lëshuar në funksion linjën e prodhimit të pijes energjike 'Golden Eagle' me kapacitet prej 50 000 copash në orë, duke i shtuar linjën aktuale kapaciteti i prodhimit të 'Golden Eagle' shkon në 66 000 copë në orë, që e bën këtë linjën më të madhe në Ballkan për prodhimin e pijeve energjike", thuhet në njoftimin e kompanisë "Frutex".



# Na duhet të shkelmojmë varësinë tonë nga suksesi



Arthur C. BROOKS

Ndoshta biseda më mbresëlënëse që bëra kur shkruajta librin tim "Nga forca në forcë", ishte me një grua rreth moshës sime. Ajo është jashtëzakonisht e suksesshme në Wall Street – ka bërë pasuri dhe është shumë e respektuar.

Mirëpo, së fundmi, ajo ka filluar të humbasë ndonjë hap aty-këtu. Vendimet e saj si menaxhere nuk janë aq të qarta sa dikur, instinktet e saj më pak të besueshme. Aty ku dikur komandonte sallën, tani sheh se kolegët e rinj dyshojnë tek vendimet e saj. Në panik nga shfaqja e mundësisë së rënies, ajo lexoi një artikull që kisha botuar dhe më pas, më shkruajti.

I bëra shumë pyetje për jetën e saj. Nuk ishte shumë e lumtur dhe nuk kishte qenë e lumtur për shumë vite – ndoshta asnjëherë. Martesa e saj ishte e pakënaqshme, tani pinte pak më shumë dhe marrëdhënia e saj me fëmijët në moshë kolegji ishte ok . . . por e largët. Ajo kishte pak miq të vërtetë. Punonte shumë orë deri vonë dhe shpesh ndihej e rraskapitur fizikisht. Puna ishte gjithçka për të – ajo "jetonte për të punuar" – dhe tani ishte e tmerruar se edhe kjo gjë kishte filluar t'i rrëshkiste nga duart.

Ajo m'i pranoi hapur këto gjëra, kështu që mund të mendoni se zgjidhja e pakënaqësisë së saj do të ishte e kollajtë. Dhe në të vërtetë, e pyeta përse nuk i korrigjonte burimet e pakënaqësisë së saj – të merrte kohë për të ringjallur martesën dhe për të kaluar më shumë kohë me fëmijët; të kërkonte ndihmë për zakonin e alkoolit; të flinte më shumë; të vinte në formë më të mirë. E dija që përpjekja e saj rraskapitëse në punë e kishte bërë atë të suksesshme, por kur kupton se diçka ka pasoja dytësore që po të shkaktojnë një gjendje të mjerë, gjen një mënyrë për ta rregulluar, apo jo? Mund ta duash bukën, por nëse bëheni intolerantë ndaj glutenit, nuk e hani më, sepse ju sëmur.

Ajo u mendua disa minuta për pyetjen time. Më në fund, më hodhi një vështrim dhe më tha: "Ndoshta do të preferoja të isha e veçantë, sesa e lumtur".

Duke parë fytyrën time të habitur, më shpjegoi: "Çdokush mund të bëjë gjërat që duhen për të qenë të lumtur: të shkojë me pushime, të kalojë kohë me miqtë dhe familjen . . . por jo të gjithë mund të arrijnë gjëra të mëdha."

Fillimisht u talla me këtë, por më pas e mendova më thellë në intimitetin e mendjes sime. Dhe kuptova që këtë zgjedhje e kam bërë edhe vetë, në disa momente të jetës sime. Ndoshta edhe shumicën e kohës, nëse dua të jem i sinqertë me veten.

Financierja kishte shpenzuar shumë vite duke krijuar një version të vetes që të tjerët do ta admironin – duke përfshirë edhe disa që kishin vdekur, si prindërit e saj. Më e rëndësishmja, vetja e saj e kuruar ishte një person që do ta admironte – një ekzekutive jashtëzakonisht e suksesshme dhe punëtore. Dhe ia doli! Por asgjë nuk është e përhershme, dhe tani ajo ndjehej sikur çdo orë pune i jepte më pak se e kaluara, dhe jo vetëm më pak lumturi – më pak fuqi dhe prestigj gjithashtu. Problemi i saj ishte se "e veçanta" që kishte krijuar, ishte më pak se një person i plotë. Mund të themi se, ajo e kishte shkëmbyer veten me një simbol të vetes.

Shumë shpesh ua bëjmë këtë njerëzve të tjerë: i reduktojmë në një ose dy karakteristika të lakmueshme si bukuria fizike, paraja ose pushteti. Ky quhet "objektivizim". Njerëzit e famshëm tregojnë shpesh, se sa e tmerrshme është të objektivizohen në këtë mënyrë. Martesat e bazuara në objektivizim – martesa për para, për shembull – dështojnë pashmangshmërisht në mënyrë të mjerueshme.

Ne e dimë në zemrat tona se objektivizimi i të tjerëve është i gabuar dhe imoral. Por është e kollajtë të harrojmë se mund t'ia bëjmë edhe vetes. Shoqja ime financiere e kishte objektivizuar veten sikur ishte e veçantë, me një vetëpërkufizim që sillej rreth punës, arritjeve, shpërblimeve të kësaj bote dhe krenarisë. Edhe pse ai objekt po gërryej ngadalë, ajo ishte shumë e lidhur me suksesin e saj botëror, për të bërë ndryshime që tani mund t'i sillnin lumturinë.

Ajo ishte e varur nga puna dhe, thellë-thellë, nga suksesi. Si të gjitha varësitë, edhe këto e kishin dehumanizuar. Ajo e shihte veten jo si një person të plotë, por më shumë si një makinë me performancë të lartë – ose ndoshta një makinë që dikur kishte performancë të lartë, por tani po shfaqte shenja konsumimi.

Fjalët e financierit më kujtuan diçka, por nuk munda të vë gishtin mbi të për disa ditë. Por më pas, m'u kujtua: një bisedë vite më parë me një mik që kishte kaluar një kohë të gjatë duke luftuar me alkoolizmin dhe varësinë nga droga. Ai më kish treguar se ishte dëshpërimisht i pakënaqur gjatë gjithë varësive të tij dhe e dinte mirë këtë. I bëra një pyetje të thjeshtë: "Nëse ndiheshe i mjerë, pse vazhdoje?" Ashtu si financierja, u ndal pak, para se t'më përgjigjej. "Më interesonte më shumë të isha high (i bërë), sesa të isha i lumtur," më tha ai.

Tani e kuptova: njerëzit që zgjedhin që, më mirë të jenë të veçantë sesa të lumtur kanë varësi.

Ndoshta ju tingëllon e çuditshme. Imagjinoni një person të dhënë dëshpërimisht pas pijeve alkoolike. Ndoshta personi që imagjinoni është poshtë nga humori, duke u vetë-mjekuar prej traumave të një bote të ashpër. Ndoshta nuk e imagjinoni të tillë, dikë që është i suksesshëm dhe punëtor. Kanë më pak gjasa të bien pre e varësive, apo jo?

Gabim. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), gjasat për të pirë alkool rriten me nivelin e arsimit dhe statusin socio-ekonomik. Disa besojnë – dhe unë jam dakord, bazuar në punën time – se njerëzit që kanë punë me presion të lartë priren të vetë-mjekohen me alkool, duke përfshirë pijen në nivele të rrezikshme, gjë që mund të çaktivizojë ndjesinë e ankthit – përkohësisht.

Por alkooli nuk është varësia e vetme ndaj së cilës janë të prirur njerëzit, apo ndoshta edhe më e keqja. Një nga varësitë më të shëmtuara dhe më virulente që kam parë është të dhënit pas punës. Termi workaholic u krijua nga psikologu Wayne Oates në vitet 1960 pasi djali i tij i kërkoi një takim në zyrë Oates për ta takuar, aq e pakët ishte koha e babait të tij. Oates e përkufizoi workaholizmin në 1971 si "detyrim ose nevojë e pakontrollueshme për të punuar në mënyrë të pandërprerë".

Udhëheqësit që punojnë me orë të vështira shpesh më thonë se nuk kanë zgjidhje, nëse duan të bëjnë punën si duhet. Por unë nuk e besoj. Kur gërmoj pak – në jetën time dhe në jetën e të tjerëve – zakonisht zbuloj se këta persona kanë ngecur në një rreth vicioz: ata bëhen të suksesshëm duke punuar më shumë se të tjerët – dhe si pasojë më shumë se sa është "e nevojshme" – por besojnë, se u duhet ta mbajnë e madje ta shtojnë ritmin, për të ruajtur produktivitetin e tyre astronomik. Shpërblimet që sjell ky produktivitet ia lënë vendin frikës se mos ngecin, e cila shërben si shtysë për të vazhduar vrapimin. Shpejt, puna zhvesh marrëdhëniet dhe aktivitetet e jashtme. Edhe pak, dhe puna është gjithçka që i mbetet personit, duke përforcuar kështu ciklin.

Workaholism-i ushqen frikën dhe vetminë; frika dhe vetmia ushqejnë workaholismin.

Ndoshta ju mund të shihni veten tek kjo. Unë mundem. Ne duhet t'u shkojmë deri në fund këtyre problemeve – objektivizimit të vetvetes, workaholismit dhe, mbi të gjitha, varësisë nga suksesi – që na lidhin me rënien tonë të pashmangshme profesionale. Por më e rëndësishmja, duhet t'i shpëtojmë këtyre tiranive në mënyrë që të mund të bëjmë kërcimin drejt suksesit të ri. / *Big Think – Bota.al*




Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Klubet e hendbollit i mësojnë kundërshtarët evropianë

KH Trepça përballet në raundin e dytë të Kupës Evropiane me skuadrën Vogoshçan nga Bosnjë-Hercegovina, ndërsa kampionët e Besës e presin fituesin e ndeshjes Beshiktash - Donbas. Skuadrat e femrave, Istogu dhe Ferizaj, do të përballen me SIR 1 Maio/CBJ, përkatësisht Maccabi Arazim Ramat Gan

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 18 korrik** - Katër klube të hendbollit e përfaqësojnë Kosovën në garat evropiane. Dy klube janë në konkurrencën e meshkujve, dy të tjera në atë të femrave. Shorti i tërhequr të martën ka përcaktuar edhe kundërshtarin e KH Trepça në raundin e dytë të Kupës Evropiane për Hendbollistë. Mitrovicasit do të përballen me skuadrën e Vogoshçan nga Bosnjë-Hercegovina. Trepça si fituese e Kupës së Kosovës nis prej raundit të dytë të EHF European Cup, kurse ndeshja e parë zhvillohet më 14 ose 15 tetor, ndërsa ndeshja e kthimit në Vogoshça më 21 ose 22 tetor. Ndërsa kampionia në fuqi e Kosovës për meshkuj, Besa Famgas, duhet të presë për ta mësuar kundërshtarin në raundin e dytë. Klubi pejan do të përballet me fituesin e ndeshjes në mes të Beshiktashit të Turqisë dhe Donbasit të Ukrainës.

Besa ndeshjen e parë e zhvillon si vendëse më 14 ose 15 tetor, kurse ndeshjen e kthimit më 21 ose 22 tetor si mysafir. Në anën tjetër, skuadra kampione e Kosovës në hendboll (femrat), Istogu, do të përballet me skuadrën nga Portugalia, SIR 1 Maio/CBJ. Kjo skuadër është nga Leiria e Portugalisë, ndërsa ka përvojë të gjatë në gara evropiane. Ndeshja e parë luhet në Portugali më 23 apo 24 shtator, ndërsa ndeshja e kthimit në Istog më 30 shtator apo 1 tetor.

Të gjitha 64 skuadrat pjesëmarrëse startojnë prej raundit të dytë të Kupës Evropiane (EHF European Cup). Ndërkohë skuadra e Ferizajt do të luajë ndaj skuadrës së Izraelit, Maccabi Arazim Ramat Gan. Ndeshja e parë luhet në Izrael (23/24 shtator), ndërsa e kthimit më 30 shtator e 1 tetor.



# 'Dardanët' kërkojnë fitore ndaj Zvicrës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prizren, 18 korrik** - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll sonte (e mërkurë) e zhvillon ndeshjen e rëndësishëm ndaj Zvicrës në kuadër të Rrethit të Tretë Parakualifikues për "Eurobasket 2025". "Dardanët" i kanë filluar përgatitjet për këtë ndeshje nga 1 korriku dhe të shtunën e kanë zhvilluar një ndeshje miqësore ndaj Shqipërisë në mënyrë që të përgatiten sa më mirë.

Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, ka bërë me dije se janë gati për këtë ndeshje kaq të rëndësishme. Ai u ka bërë thirrje tifozëve që të mërkurën të jenë në palestër në numër sa më të madh, pasi kjo do t'i ndihmonte Kosovës për të arritur fitore. "Nuk ka qenë lehtë, pasi ka qenë 2 muaj pushim, por besoj se jemi gati dhe do ta japim maksimumin. Të mërkurën është ndeshja e parë dhe tepër me rëndësi për ne. Përkrahja nga tifozët është shumë e rëndësishme për ne. Kushtet kanë qenë të mira nga ana e FBK-së dhe me punën e trajnerit që ka bërë, jemi gati. Besoj se palestra do të jetë e mbushur dhe do ta kemi përkrahjen e tyre. Ne do të japim 100 % nga vetja jonë. Mendoj se jemi më të fortë se herët e kaluara, pasi Lisi (Shoshi) dhe Dardani (Kapiti) janë rikthyer në kombëtare. E rëndësishme për ne është ta luajmë lojën tonë", ka thënë Berisha.

Kosova pas kësaj ndeshje më 26 korrik është mysafire e Danimarkës, kurse më 29 korrik luan ndeshjen tjetër ndaj Zvicrës. Ndeshjen e fundit "dardanët" e zhvillojnë më 5 gusht ndaj Danimarkës. Vetëm vendi i parë kualifikohet tutje.

# 19 sportistë përfaqësojnë Kosovën në EYOF Maribor 2023

Prishtinë, 18 korrik - 19 sportistë të rinj do ta përfaqësojnë Kosovën në Festivalin Olimpik Evropian Veror për të Rinj (EYOF), i cili prej 23-29 korrik 2023 do të mbahet në Maribor të Sllovenisë. Sportistët janë të sporteve të xhudos, atletikës, notit, tenisit dhe çiklizmit. Më së shumti janë nga xhudo, gjashtë, ndërsa atletika, noti e tenisi përfaqësohen me nga katër. Çiklizmi përfaqësohet me një sportist. Në EYOF marrin pjesë sportistë të moshave 14-18-vjeçare nga 48 shtete të Evropës.

Pjesë e ekipit janë edhe pesë trajnerë, si dhe Blearta Ukëhaxhaj nga tenisi, në cilësinë e ambasadores së Komitetit Olimpik të Evropës.

Për Kosovën do të jetë pjesëmarrja e pestë në EYOF veror, pas Tbilisi 2015, Gyor 2017, Baku 2019 dhe Banska Bystrica 2022. Nga të gjitha edicionet, vendi ynë numëron vetëm një medalje të artë, të fituar nga atleti Muhamet Ramadani në Baku 2019.

Lista e sportistëve: Laurinë Gashi, Ujves Nesimi, Andi Reshitaj, Jon Veseli, Art Thaçi, Blin Kuka (xhudo), Emine Jenuzi, Gerta Gashi, Shkëlqim Deliu, Vesa Jusufi (atletikë), Adora Hoxha, Arion Budima, Buntrint Hashani, Olta Berisha (not), Ervin Doli, Salidin Rama, Meldima Mislimi, Altea Hajrizi (tenis), Visar Nuhaj (çiklizëm).





## Sonte Ballkani zhvillon ndeshjen kthyese ndaj Ludogoretsit

**Suharekë, 18 korrik** - Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Ballkani, të martën ka mbërritur në Bullgari, ku edhe e zhvillon ndeshjen kthyese kundër Ludogoretsit në kuadër të raundit kualifikues në Ligën e Kampionëve.

Skuadra e drejtuar nga trajneri shqiptar, Ilir Daja, ka shkëlqyer në ndeshjen e parë që është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri", duke regjistruar fitore me rezultat 2-0. Kampioni i Kosovës synon rezultat pozitiv edhe në ndeshjen kthyese në Razgrad që do të zhvillohet sot (e mërkurë) në "Huvepharma Arena" me fillim nga ora 20:00 në mënyrë që të kualifikohet në fazën tjetër të garës më të fortë në futboll.

## Bayerni e dëshiron Strakoshën si zëvendësues të Neuerit




**Munchen, 18 korrik -** Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Thomas Strakosha, është në "radar" të Bayern Munchenit. Në fakt, nga klubi gjerman pritet të largohet portieri Sommer, pasi në portë tashmë do të jetë Manuel Neuer si pasojë e rikuperimit të plotë. Bayerni po shqyrton dy portierë të rinj për të qenë opsion rezervë dhe një ndër ta është edhe Strakosha. Emri i gardianit të Kombëtares shqiptare ka dalë në radarin e gjigantëve bavarezë, të cilët nuk duan të shpenzojnë shumë për këtë pozicion. Siç raportohet nga "Sky Germany", Strakosha dhe Dominik Kotarski janë diskutuar si alternativa të mundshme. Strakosha e kaloi sezonin e fundit në Brentford, ku pati vështirësi për minuta, duke luajtur vetëm dy herë në gjithë vitin, teksa garoi me portierin spanjoll David Raja, i cili nuk është shitur ende nga klubi anglez, teksa është afruar edhe Fliken nga Bundesliga. Megjithatë, 28-vjeçari i Kombëtares shqiptare ka një përvojë të gjatë mbi supe me Lazion, duke numëruar 208 paraqitje, me 62 rrjeta të paprekura.

# Tare: Nuk do të shkoj te Chelsea



**Tiranë, 18 korrik -** Igli Tare, pas largimit si drejtor i Lazios, të cilën pozitë e mbajti për rreth 15 vjet, ka vendosur të qëndrojë në Shqipëri për pushimet verore duke pritur dhe shqyrtuar ofertat për një aventurë të re. Darka e tij me pronarin e Chelseas, Todd Boehly, në një nga resorët turistikë në jug të vendit, bëri zhurmë rreth një kalimi të tij të mundshëm në drejtimin e skuadrës londineze. "Top Channel" ka kontaktuar nëpërmjet gazetarit Endi Tufa me ish-drejtorin e Lazios, Igli Tare, i cili, i pyetur nëse ka diçka të vërtetë rreth një bisede të mundshme për kalimin e tij në futbollin më të bukur në Evropë, Premierë Ligë dhe ish-drejtori i skuadrës së Serisë A, ka përgënjeshtruar një lajm të tillë. "Todd Boehly është i njohuri im dhe kam darkuar me të për këtë arsye. Nuk ka asgjë të vërtetë rreth këtyre lajmeve që qarkullojnë", është përgjigjur Igli Tare.
Me sa duket deri në marrjen e një vendimi se ku do të jetë e ardhmja e Tares do të ketë shumë fjalë dhe, ndoshta, me të drejtë, duke qenë se për të kanë shprehur shpesh interesim klube të rëndësishme jo vetëm në Itali, por edhe në kampionate të tjera.

# Ronaldo 'thumbon' Messin: Liga saudite, më e mirë se ajo amerikane



**Riyadh, 18 korrik -** Cristiano Ronaldo është i bindur se ka bërë zgjedhjen e duhur duke u transferuar në Arabinë Saudite te skuadra e Al-Nassrit. Portugezi la kampionatin anglez në merkaton e janarit duke mbyllur historinë e tij me Manchester Unitedin, por edhe me futbollin në Evropë pasi, së fundmi, CR7 theksoi se nuk do të rikthehet më në Kontinentin e Vjetër. Pas ndeshjes miqësore që Al-Nassri zhvilloi me Celta Vigon, 38-vjeçari u shpreh se nuk do të luajë sërish në Evropë, ndërsa nuk ngurroi të theksonte se futbolli në Evropë ka humbur cilësitë e dikurshme, ndërsa veçoi vetëm Premierë Ligën si kampionatin që ia vlen të luash. "Kur u bashkova me Juventusin, Seria A ishte e 'vdekur'. Por, pasi unë firmosa pati një ringjalljе. Kudo që shkon Cristiano Ronaldo interesimi rritet dhe kjo është e dukshme. Më kanë kritikuar për transferimin në Arabinë Saudite, po tani që të gjithë po vijnë këtu? Unë hapa rrugën dhe të gjithë futbollistët nuk e nënvlerësojnë më një ofertë nga Arabia. Nuk do të kthehem më në Evropë. Aty futbolli ka humbur shumë kualitet. Mund të veçoj vetëm Premierë Ligën. Është shumë përpara të tjerëve. Theksoj se 100 % nuk kthehem në Evropë. Të gjitha dyert janë të mbyllura. Unë nisa një epokë të re për Ligën Arabe dhe shumë lojtarë po vijnë këtu", ka thënë Ronaldo.
Sakaq, nuk mungoi edhe një "thumbim" i luzitanit për Lionel Messin dhe zgjedhjen e argjentinasit për të luajtur në Amerikë me Inter Miamin. Ronaldo u shpreh i bindur se Liga Arabe është shumë më e mirë dhe e fortë se MLS-ja në Amerikë. Kujtojmë se Lionel Messi e refuzoi ftesën e arabëve dhe saktësisht klubit të Al-Hilal duke zgjedhur Amerikën dhe klubin e David Beckhamit.

## SHKURT

### Rezart Memedi përforcon KB Ylli

Rezart Memedi është përforcimi i radhës i Golden Eagle Yllit. Klubi nga Suhareka njoftoi zyrtarisht për arritjen e marrëveshjes me basketbollistin nga Maqedonia e Veriut. Memedi së fundmi ishte pjesë e Sigal Prishtinës. "Rrezart Memedi bashkohet me ne! Rrezarti vitin e kaluar luajti me mesatare prej 15 minutash, 6 pikë, 1 kërcim, 1 asistim për ndeshje. Kishte saktësi për 3 pikë prej 43 %", thuhet në njoftimin e KB Ylli.

### FC Phoenix rikthen vëllezërit Lushi

Skuadra e Ligës së Parë, FC Phoenix, është përforcuar me dy talentë të futbollit. Fjala është për vëllezërit Avdullah dhe Herolind Lushi. Këta futbollistë edhe në të kaluarën ishin pjesë e skuadrës nga Banja e Pejës. "Mirë se vini vëllezërit Lushi! FC Phoenix ju njofton se në kuadër të transfereve për sezonin 2023/2024 ka arritur marrëveshje me dy talentët Avdullah dhe Herolind Lushi. Avdullahi dhe Herolindi kthehen në FC Phonix nga Dardania! Avdullahit dhe Herolindit u urojmë suksese. Bashkë drejt objektiva", thuhet në njoftimin e FC Phonix.

### Theu raketën në finalen e Wimbledonit, dënohet Gjokoviqi

Tenisti serb Novak Gjokoviqi është gjobitur për shkak se theu raketën duke goditur shtyllën e rrjetës gjatë finales së Wimbledonit. Shtatë herë fituesi i Wimbledonit është ndëshkuar me tetë mijë dollarë. Ai gjatë ndeshjes të së dielës humbi ndaj 20-vjeçarit spanjoll Carlos Alcaraz. Alcarazi e fitoi turneun e Wimbledonit për herë të parë në karrierë, pasi e mposhti Gjokiviqin me rezultat 3-2 në sete. Spanjolli si 20-vjeçar e ka fituar Grand Slamin e dytë.

### Verstappeni: Një ditë do të kem skuadrën time në gara

Dy herë kampioni i botës në Formula 1, piloti holandez i Red Bull Racing, Max Verstappen, në një intervistë për "CNN Sport", ka folur për të ardhmen e tij. Ai ka pranuar pasionin e tij për garat virtuale me të cilat shpesh kalon kohën e lirë kur nuk është duke zhvilluar gara. "Një ditë dëshiroj të kem skuadrën time. Madje kam nisur që tani punën, duke përdorur 'verstappen.com Racing', një skuadër që është integruar në botën reale të sim-Racing", u shpreh piloti holandez. "I adhuroj garat e simuluara. Disa mendojnë se janë thjesht një lojë, por nuk është kështu. Jam i apasinuar pas tyre dhe kam mjaft projekte për të ardhmen. Dua të ndërtoj diçka brenda kësaj bote, për të sjellë disa gara në botën reale", ka deklaruar Max Verstappen.
Duke folur nëse ekziston mundësia që në të ardhmen ta bëjë detyrën e drejtorit sportiv në Formula 1, ai mohon kategorikisht: "Formula 1 është një sport që kërkon shumë udhëtime, gjë të cilën po e përjetoj si pilot. Ndaj, nuk kam aspak dëshirë ta bëj edhe drejtuesin në të ardhmen".

## Ish-trajneri i Arsenalit, Arsena Wenger: Ka ardhur koha ta fitojmë Premierë Ligën

Arsenali është forcuar shumë kohën e fundit, teksa në sezonin që kaloi luftoi deri në fund për titullin kampion. Për "Gunners" ka folur ish-trajneri i londinezëve, Arsene Wenger, i cili është shprehur se ka ardhur koha që ekipi ta fitojë titullin. "Arsenali ka bërë investime të mira në përgjithësi. Afrimet janë lojtarë të pjekur, edhe pse ende të rinj. Janë 23-24 vjeç dhe e kanë të ardhmen përpara. Skuadra do të ketë më shumë presion krahasuar me sezonin e kaluar, por di ta menaxhojnë nëse ka mësuar nga gabimet e edicionit të fundit. Gjithsesi, ne do ta fitojmë Premierë Ligën", ka thënë Wengeri.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**DREJTORIA E ARSIMIT**
**03-111/01-145739/23**
**Datë: 14.07.2023**

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës:

**RISHPALLË KONKURS**
**PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

**Titulli i vendit të punës:**

1. Drejtor/e në SHFMU "Asim Vokshi", Komuna e Prishtinës;
2. Drejtor/e në SHFMU "Emin Duraku", Komuna e Prishtinës;
3. Drejtor/e në SHFMU "Gjergj Fishta", Komuna e Prishtinës;
4. Drejtor/e në SHFMU "Nazim Gafurri", Komuna e Prishtinës;
5. Drejtor/e në SHFMU "Pavarësia", Komuna e Prishtinës;
6. Drejtor/e në SHFMU "Shkolla e Gjelbërt", Komuna e Prishtinës;
7. Drejtor/e në SHFMU "Pjeter Bogdani", Komuna e Prishtinës;
8. Drejtor/e në SHFMU "Ali Kelmendi", Komuna e Prishtinës;
9. Drejtor/e në SHFMU "Iliria", Komuna e Prishtinës;
10. Drejtor/e në SHFMU "Dituria", Komuna e Prishtinës;
11. Drejtor/e në SHFMU "Mehmet Gjevori", Komuna e Prishtinës;
12. Drejtor/e në SHFMU "Avni Rrustemi", Komuna e Prishtinës;
13. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Faik Konica", Komuna e Prishtinës;
14. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Dardania", Komuna e Prishtinës;
15. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Hasan Prishtina", Komuna e Prishtinës;

**DHE SHPALLË KONKURS**
**PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

**Titulli i vendit të punës:**

1. Drejtor/e në SHFMU "Andon Z. Cajupi", Komuna e Prishtinës;
2. Drejtor/e në SHFMU "Naim Frashëri", Komuna e Prishtinës;
3. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Ismail Qemaili", Komuna e Prishtinës;
4. Zëvendësdrejtor/e në SHFMU "Iliria", Komuna e Prishtinës;

**Institucioni:** **Komuna e Prishtinës**
**Drejtoria:** **Drejtoria për Arsim**
**Lloji i pozitës:** **Nëpunës i Shërbimit Publik**
**Titiulli i mbikëqyrësit:** **Drejtoria e Arsimit**
**Kohëzgjatja e emërimit:** **Katër (4) vite;**

**Qëllimi i vendit të punës:** Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

**1. Informata të përgjithshme**

1.1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.07.2023 deri më datën 28.07.2023;
1.2. Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
1.3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
1.4. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
1.5. Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
1.6. Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
1.7. Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
1.8. Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë te aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
1.9. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
1.10. Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

***Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

**2. Kushtet**

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

2.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
2.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
2.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
2.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
2.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
2.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve[1];
2.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimet të KSHLM;
2.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
2.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
2.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
2.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor/eshë.
2.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.[2]

**3. Dokumentet e kërkuara**

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:
3.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;

[1] Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzojë dëshmi nga MASHT për këtë.
[2] Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional

3.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
3.2.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
3.3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
3.4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
3.5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët[3];
3.6. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor[4];
3.7. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike[5];
3.8. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës[6];

**4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë**

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

4.1. Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
4.2. Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
4.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
4.4. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
4.5. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;

[3] Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbyllura apo të hapura kundër tyre.
[4] Shihni Formularin B/1 për kriteret e pikëzimit të dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale.
[5] Shihni Formularin I - Model i Deklaratës nën Betim.
[6] Shihni Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale, por po ashtu Formularin B/1 rreth kritereve të pikëzimit të dokumenteve.

4.6. Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucioni edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
4.7. Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
4.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
4.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
4.10. Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

**5. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse**

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planet zhvillimore të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

**6. Vegëzat elektronike**

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojme te gjithë kandidatet qe t'i lexojne me kujdes te gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhes nga Komisioni i emëruar.

**Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020** për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:
https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/

**Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020** - dukë perfshirë Forumularet të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmive të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokolli i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iea/

**Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH)** 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional

Linku:
https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/

**Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës**
Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:
https://prishtinaonline.com/uploads/1_udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_.docx.pdf

**Shtojca 5 - Dokument informues për vezhguesit e Komisioneve përzgjedhëse**

Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcen bazë e cila do të përdoret nga Komisoni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje më UA151/2020.

Linku:
https://prishtinaonline.com/uploads/1dokumenti_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve.pdf

---

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

PRISHTINA

**DREJTORIA E ARSIMIT**
**03-111/01-145747/23**
**Datë: 14.07.2023**

Bazuar në nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. Nr. 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 5 pika (d) të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria për Arsim në Komunën e Prishtinës:

**SHPALLË KONKURS**
**PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

**Titulli i vendit të punës:**

1. Zëvendësdrejtor/e në SHML "28 Nëntori", Komuna e Prishtinës;
2. Zëvendësdrejtor/e në SHML "Gjin Gazulli", Komuna e Prishtinës;

| | |
|---|---|
| **Institucioni:** | **Komuna e Prishtinës** |
| **Drejtoria:** | **Drejtoria për Arsim** |
| **Lloji i pozitës:** | **Nëpunës i Shërbimit Publik** |
| **Titiulli i mbikëqyrësit:** | **Drejtoria e Arsimit** |
| **Kohëzgjatja e emërimit:** | **Katër (4) vite;** |

**Qëllimi i vendit të punës:** Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

**1. Informata të përgjithshme**

1.1. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.07.2023 deri më datën 28.07.2023;
1.2. Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës rr. UÇK-2, 10000, Prishtinë.
1.3. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
1.4. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
1.5. Për qëllime të arkivimit, i tërë dokumentacioni që dorëzohet për aplikim si kopje fizike, gjithashtu duhet të jetë i skenuar dhe i vendosur në USB (USB-në mund ta merrni prapa pasi të përfundon konkursi);
1.6. Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
1.7. Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
1.8. Kandidati/ja në një konkurs publik ka të drejtë te aplikoj në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
1.9. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;
1.10. Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse.

***Vërejtje:** **Të gjitha aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.**

**2. Kushtet**

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:

2.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2.2. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm:
 2.2.1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 2.2.2. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 2.2.3. Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 2.2.4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
2.3. Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve[1];
2.4. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimet të KSHLM;
2.5. Të ketë përvojë pune në procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:

[1] Nëse kandidati/ja është në proces të ri-licencimit, të dorëzojë dëshmi nga MASHT për këtë.

2.5.1. Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë;
2.5.2. Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët/et për drejtor/eshës në nivele tjera, dhe
2.5.3. Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor/eshë.

2.6. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.[2]

**3. Dokumentet e kërkuara**

Kandidatët duhet të posedojnë dhe dëshmojnë dokumentet, si në vijim:

3.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
3.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
3.2.1. Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
3.3. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID).
3.4. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
3.5. Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët[3];
3.6. Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor[4];
3.7. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike[5];
3.8. Portfolion profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës[6];

**4. Detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorë**

Drejtori ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

[2] Shihni UA 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional
[3] Përpos dokumenteve të cekura në pikën 3.5, DKA Prishtinë do të kërkojë nga Inspektorati për Arsim nëse kandidatët që kanë konkurruar kanë raste të mbyllura apo të hapura kundër tyre.
[4] Shihni Formularin B/1 për kriteret e pikëzimit të dokumenteve, si dhe Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale.
[5] Shihni Formularin I - Model i Deklaratës nën Betim.
[6] Shihni Formularin H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale, por po ashtu Formularin B/1 rreth kritereve të pikëzimit të dokumenteve.

4.1. Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës;
4.2. Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
4.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
4.4. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
4.5. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmave tjerë të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës së institucionit dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
4.6. Bashkëpunon me Këshillin drejtues të institucioni edukativo-arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor;
4.7. Raporton së paku dy herë në vit para KDSH;
4.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
4.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);
4.10. Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASH dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

**5. Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatëse**

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, në linkun e mëposhtëm gjeni Planet zhvillimore të IEAA-ve të Komunës të Prishtinës, si vijon: https://prishtinaonline.com/drejtorite/arsimit/planet-zhvillimore-ieea

Për çdo problematikë teknike në sigurimin e Planit Zhvillimor të IEAA-së përkatëse, mund të drejtoheni në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

**6. Vegëzat elektronike**

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojme te gjithë kandidatet qe t'i lexojne me kujdes te gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhes nga Komisioni i emëruar.

**Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020** për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:
https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dhe-pergjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dhe-aftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/

**Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020** - dukë perfshirë Forumularet të cilat janë kyçe për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:
- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmive të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokolli i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku: https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-per-drejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iea/

**Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH)** 05/2015 Normativi për Mësimdhenesit e Arsimit Profesional

Linku:
https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimit-profesional/

**Shtojca 4 - Udhëzues për kandidatët për fazën e intervistës**
Qëllimi i këtij dokumenti është që të i jap disa informata kandidatëve rreth mbarëvajtjes së procesit të përzgjedhjes dhe rreth asaj se çka mund të presin kandidatët gjatë ditës së intervistave.

Linku:
https://prishtinaonline.com/uploads/1_udhezues_per_kandidatet_per_fazen_e_intervistes_per_kandidatet_ne_pozita_udheheqese_te_institucioneve_edukativo-arsimore_.docx.pdf

**Shtojca 5 - Dokument informues për vezhguesit e Komisioneve përzgjedhëse**
Për hir të transparencës maksimale për kandidatët, vëzhguesit si dhe qytetarët e interesuar, më poshtë gjeni shtojcen bazë e cila do të përdoret nga Komisoni gjatë punës së tyre, dhe që është në përputhje më UA151/2020.
Linku:
https://prishtinaonline.com/uploads/1dokumenti_informues_per_vezhguesit_e_komisioneve.pdf

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania " **ENDO SAVUNMA VE İNŞAAT SANAYİ ANONİM ŞİRKETİ BRANCH İN KOSOVO "** me seli në **Prizren**, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të unik: **811916264** dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedures së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazette.

## OBAVESTENJE

Obavještavamo se svi klienti da Tvrtka " **ENDO SAVUNMA VE İNŞAAT SANAYİ ANONİM ŞİRKETİ BRANCH İN KOSOVO "** u **Prizren,** doneo odluku da ugasi biznis po br. Registra: **811916264** I ujedno imenovao Likfidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze I potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company **"ENDO SAVUNMA VE İNŞAAT SANAYİ ANONİM ŞİRKETİ BRANCH İN KOSOVO "** in **Prizren** has come to the decision to quit its business with registry: **811916264.** The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

**Bilanci i gjendjes me : 30.06.2023** Euro'000

| | Tremujori paraprak | Tremujori vijues |
|---|---|---|
| **Pasurite** | | |
| | | |
| Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në | 12,448 | 8,772 |
| Kërkesat ndaj bankave | 1,579 | 3,451 |
| Bonot e thesarit | - | - |
| Investimet në letra me vlerë | 5,920 | 3,992 |
| Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve | 93,524 | 97,989 |
| Patundshmëritë dhe pajisjet | 1,624 | 1,512 |
| Pasuritë e paprekshme | 164 | 146 |
| Pasuritë tatimore të shtyra | - | - |
| Pasuritë tjera | 121 | 106 |
| **Gjithsej pasuritë** | **115,381** | **115,967** |
| | | |
| **Detyrimet** | | |
| | | |
| Depozitat e klientëve | 84,605 | 81,731 |
| Detyrimet ndaj bankave | 8,892 | 12,370 |
| Fondet tjera të huazuara | - | - |
| Detyrimet tatimore të shtyra | - | - |
| Detyrimet tjera | 1,253 | 1,071 |
| **Gjithsej detyrimet** | **94,751** | **95,172** |
| | | |
| **Ekuiteti i aksionarëve** | | |
| | | |
| Kapitali aksionar | 20,000 | 20,000 |
| Rezervat e kapitalit | - | - |
| Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake | 220 | 220 |
| Fitimi/(humbja) e vitit aktual | 410 | 575 |
| Përbërësit tjerë të ekuitetit | - | - |
| **Gjithsej ekuiteti i aksionarëve** | **20,630** | **20,795** |
| | | |
| **Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve** | **115,381** | **115,967** |

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

**Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.06.2023** Euro'000

| | Tremujori paraprak | Tremujori vijues |
|---|---|---|
| | | |
| Të hyrat nga interesi | 1,768 | 3,381 |
| Shpenzimet e interesit | - 543 | - 1,039 |
| **Neto të hyrat nga interesi** | **1,225** | **2,343** |
| | | |
| Të hyrat nga tarifat dhe komisionet | 56 | 105 |
| Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve | - 59 | - 108 |
| **Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet** | **- 4** | **- 3** |
| | | |
| Neto të hyrat nga tregtimi | 1 | 3 |
| Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare | - | 0 |
| Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative | - 568 | - 1,170 |
| | | |
| **Gjithsej të hyrat** | **654** | **1,174** |
| | | |
| Provizionet për humbjet nga kreditë | - 260 | - 574 |
| Provizionet tjera | 33 | 55 |
| **Fitimi/(humbja) para tatimit** | **427** | **654** |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | - 17 | - 79 |
| Shpenzimet e tatimit të shtyer | - | - |
| **Fitimi/(humbja) neto** | **410** | **575** |
| | | |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse | - | - |
| | | |
| **Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse** | **410** | **575** |




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erilind Bogaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX, shfmu "Deshmoret e Kabashit" Korishe.

- Fadil Cenau shpall te pavlefshme deftesat e kp I - VIII, shfmu "Bajram Curi" Romaje.

- Fazli Musaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - IX, shfmu "Pheter Budi" Lubizhde Has.

- Perparim Musaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII, "shfmu" Pjeter Budi" Lubizhde Has.

- Nexhmedin Musaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I - VIII, shfmu " Pjeter Budi" Lubizhde Has.

- Ibrahim Jakup Brahimi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Dhjetë (10) dhe njëmbëdhjetë (11) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Ylli Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë (10) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 1,2,3,4 të QAMO-s, "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Xhemil Gjini shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Olti Bajrami shpall te pavlefshme diplomën dhe certifikatën te CMSh QK "11 Marsi " Prizren.

- Nevruz Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e QAMO"Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e QAMO "Nexhmedin Nixha" .

- Dion Zeqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Muzikës "Prenk Jakova" Gjakovë.

- Dion Zeqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shf.m.u. "Selman Riza" nga kl. 6-9 Gjakovë.

- Jozef Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Jeta Meqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat 10.11.12 si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L